



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2483/ 4 prot

Datë 13.10.2025

V E N D I M

Nr. 1435 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.10.2025, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e operatorit ekonomik “IN PRINT” ShPK për procedurën e prokurimit “*E hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-60329-09-04-2025, me objekt “Shërbim printimi” me fond limit: 2,236,500 lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.09.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastrë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK me NIPT L92713601Q dhe adresë: *Bulevardi Zhan D'ark, Pallati 53, Ap 6b, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Gjirokastrë
Adresa: Rr. George Sorros, Gjirokastrë.
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 08.09.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-60329-09-04-2025, me objekt “Shërbim printimi” me fond limit: 2,236,500 lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.09.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastrë.

II.2. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK ka paraqitur ankesë me numër ankimi elektronik A/2025/5805 datë 15.09.2025 dhe me nr. 2483/2025 prot., datë 15.09.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë Autortitetit Kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 9609 prot., datë 22.09.2025 protokolluar me tonën me nr. 2483/1 prot., datë 24.09.2025 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së ankimuesi, bashkëlidhur së cilës gjendet Kthim përgjigje ankesës, për procedurën e prokurimit “Shërbim printimi”. Referuar informacionit AK ka vendosur pranimin e plotë të ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “IN PRINT” ShPK, mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, Shtojca 9, me argumente si vijon.:

Ne Shtojcen 9, 2 Krite të vecanta për kualifikim, 2.3. Kapaciteti teknik,

2.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimit objekt kontrate, duhet të disponojë *minimalisht 2 punonjës të profilit IT* të cilët duhet të jenë në listëpagesat e muajit Korrik 2025.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punonjësit që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Me argumente në mënyrë të përmbledhur si vijon:

Te modifikohet:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjes për pajisjet që oferton, ose me certifikatë ekuivalente të lëshuar nga institucionet e autorizuar të akredituara nga DPA ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, apo distributori i autorizuar për pajisjet që posedon me kusht që të provohet e drejta legjitime për të trajnuar dhe certifikuar stafin për mirëmbajtjen e pajisjeve.

Për këtë të paraqiten:

-certifikata e trajnimit (certifikata e trajnimit të paraqitet në sitemin e SPE).

-Punonjësit duhet të jenë në listëpagesat e muajit korrik 2025.

III.1.1 Autoriteti Kontraktor me shkesën: Kthim përgjigje ankesës për procedurën e prokurimit “Shërbim printimi” ka vendosur pranimin e plotë të ankesës.

*Referuar pretendimeve të ankimuesit për modifikimin e kriterit 2.7 të kapacitetit teknik , duhet të disponojë **minimalisht 2 punonjës të profilit IT** të cilët duhet të jenë në listëpagesat e muajit Korrik 2025, të modifikohet pasi për realizimin e këtij objekti mjafton që operatori ekonomik të ketë të punësuar staf teknik të paktën 2 (dy) punonjës **të certifikuar nga prodhuesi për pajisjet për të cilat ofron shërbimin ose ekuivalente.***

Përsa më sipër në cilësinë e Zyrtarit të Autorizuar të Autoritetit Kontraktor vlerësoj dhe vendos të pranojë ankesën tuaj në bazë të nenit 114 të LPP-së.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pikat 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se:

1. “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar nga autoriteti kontraktor, Komisioni konstaton, se ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues “IN PRINT” ShPK, për procedurën e prokurimit “E hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-60329-09-04-2025, me objekt “Shërbim printimi” me fond limit: 2,236,500 lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar më datë 18.09.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastrë.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK për procedurën e prokurimit “*E hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-60329-09-04-2025, me objekt “Shërbim printimi” me fond limit: 2,236,500 lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 18.09.2025, nga autoriteti kontraktor Bashkia Gjirokastrë.
2. Autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet me shtojcën përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke publikuar shtojcën me modifikim të kriterit, sipas vendimit të KSHA-së e dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “IN PRINT” ShPK.
5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

